

Forma për konsultime legjislative

Emri i dokumentit të komentuar: Projektligji për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike

Numri i dokumentit:

Akterët e përfshirë në këtë proces: Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Instituti GAP

A ka qenë i publikuar dokumenti për konsultim/komentim nga organizatat e shoqërisë civile: Jo.

Forma për konsultime legjislative i drejtohet: Komisioni për Integritet Evropian, Kuvendi i Kosovës

Nenet/dispozitat që kërkojnë rishikim dhe/apo përmirësim:

Neni	Projektligji	Rekomandimet e Forumit të OJQ-ve	Arsyetimi:
1	Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i fushës së përgjimit dhe përcaktimi i rregullave dhe procedurave për Operatorët e Rrjeteve dhe Ofruesit e Shërbimeve në lidhje me ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave të caktuara nga Operatorët e Rrjeteve dhe Ofruesit e Shërbimeve, në mënyrë që të sigurohet se të dhënat janë në dispozicion me qëllim të hetimit, zbulimit dhe ndjekjes së krimeve të rënda përmes përgjimit të ligjshëm të komunikimit elektronik të kërkuar nga Institucionet e Autorizuara dhe të autorizuara nga gjykatat kompetente, për qëllim të zbatimit të ligjit dhe/ose të sigurisë	Projektligji duhet të ketë qëllimin e qartë, dhe t'i përmbahet qëllimit në nenet më poshtë. Projektligji nuk rregullon tërë procesin e përgjimit, dhe përzien detyrat e Policisë me ato të AKI-së.	Projektligji nuk bën dallim në mes të përgjimit për nevoja gjyqësore dhe përgjimit për nevoja të inteligjencës. Projektligji më shumë merret me përcaktimin e rregullave dhe procedurave për Operatorët e Rrjeteve/Ofruesit e Shërbimeve, se sa me rregullimin e procesit të përgjimit. Ky nen përmend që të dhënat duhet të jenë në dispozicion me qëllim të hetimit, zbulimit, dhe ndjekjes së krimeve të rënda, dhe i njëjti përmend AKI si institucion i autorizuar në këtë projektligj. Atëherë, ky nen bën një përzierje të përgjegjësive në përgjim në mes të Policisë së Kosovës dhe AKI-së, sepse hetimi i krimeve është detyrë e Policisë së Kosovës, dhe jo e AKI-së.



An EU funded project managed by the European Union Office in Kosovo

Implemented by:



	kombëtare, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), Ligjin mbi Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë (AKI), Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Ligjin për Komunikimet Elektronike, si dhe duke marrë parasysh Rezolutën e Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 17 Janar 1995 mbi Përgjimin Ligjor të Telekomunikimeve		
3, pika 1.1	"Institucion i autorizuar" nënkupton Policinë e Kosovës, Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, dhe institucionet të autorizuar me ligje të veqanta për përgjim të telekomunikimeve në bazë të autorizimit ligjor dhe urdhrat të ligjshëm për përgjim i cili është i lëshuar në përputhje të plotë me Kodin e Procedurës Penale në Kosovë dhe Ligjin për Agjencinë Kosovare për Inteligjencë;	Projektligji duhet të cek pozitën në Polici dhe AKI që kanë të drejtë të kërkesës për përgjim. Po ashtu, duhet të cekë edhe institucionet tjera të autorizuar për përgjim.	Në këtë pikë përmenden Policia e Kosovës dhe AKI si institucione të autorizuar për përgjim, dhe nuk ceket se kush në këto institucione është i autorizuar të kërkojë përgjim nga operatorët e rrjetit. Mos definimi i listës së pozitive me të drejtë kërkesë për përgjim krijon hapësirë për keqpërdorime të përgjimeve në praktikë. Për më shumë, ky nen bie edhe në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale i cili në Nenin 91.1 përcakton Prokurorin e Shtetit si institucionin që ka të drejtën të bëjë kërkesë tek gjyqtari përkatës për fillimin e procedurave për përgjim;
3, pika 1.7	"Njësitë ndërlidhëse" është vendndodhja fizike e pajisjeve teknike brenda objekteve të operatorit/ofruesit të shërbimit të rrjetit të komunikimit elektronik dhe Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë ku qasje në komunikimet e përgjuara ose të dhënat që lidhen me thirrjen është i siguruar. Ndërlidhja e përgjimit nuk është domosdoshmërisht një pikë e vetme, fikse;	Projektligji duhet të saktësojë që njësitë ndërlidhëse (apo interception interface) janë të vendosura në operator të rrjetit, dhe jo edhe nën AKI. Kjo e fundit ka vetëm qendrën monitoruese ku transmetohet përgjimi nga njësia ndërlidhëse e operatorit të rrjetit.	Njësitë ndërlidhëse apo "interception interface" nuk kanë fare të bëjnë me institucionin e autorizuar për përgjim, por me operatorët e rrjetit, ndërsa në projektligj përmendet AKI si njëri nga institucionet ku janë të vendosur "njësitë ndërlidhëse". D.m.th. sipas projektligjit, njësitë ndërlidhëse vendosen në objektet e operatorëve të rrjetit dhe AKI-së, derisa sipas Rezolutës së Këshillit të BE-së të datës 17 Janar 1995, të cilës i referohet ky projektligj, njësitë ndërlidhëse (interception interface) janë në kuadër të operatorëve të rrjetit/ofruesit të shërbimeve.
3, pika 1.8	"Qendrat Monitoruese" nënkupton infrastrukturën e ndara të Policisë së Kosovës dhe Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë që administrojnë sistemet e përgjimit, të përcaktuar si destinacion i transmetimit për	Projektligji duhet të saktësojë që qendrat monitoruese nuk administrojnë sistemet e përgjimit. Ato janë vetëm destinacioni i fundit ku transmetohet përgjimi.	Qendrat monitoruese janë destinimi ku transmetohet përgjimi i realizuar, por nuk administrojnë sistemet e përgjimit ashtu siç thuhet në projektligj. Ato paraqesin vetëm njësitë ku regjistrohet telekomunikimi i përgjuar e që janë pjesë e institucioneve të autorizuar për përgjim (ang. Laë enforcement monitoring



An EU funded project managed by the European Union Office in Kosovo

Implemented by:



	komunikimet e përgjuara dhe i të dhënave që lidhen me thirrjen e ndonjë caku të caktuar të përgjimit, dhe ku është e vendosur pajisja për monitorim dhe incizim i Institucionit të Autorizuar;		facility).
3, pika 1.11	“Komunikimi Elektronik ” nënkupton secilin transferim të shenjave, sinjaleve, të të shkruarit, imazheve, tingujve apo të dhënave të ndonjë natyre të transmetuar në tërësi apo në veçanti përmes sistemit të telit, radios, elektromagnetik, foto-elektronik apo foto-optik;	Projektligji nuk duhet të ngatërrojë përkthimin e neneve dhe përkufizimeve nga Rezoluta e BE-së mbi përgjimin ligjore të telekomunikimeve.	Kjo pikë paraqet dyfishim me pikën 1.6 (objekt përgjimi) sepse objekt përgjimi janë ato që i përfshinë definicioni i komunikimit elektronik në projektligj, dhe jo ato që përmban definicioni i objektit të përgjimit në pikën 1.6. Këto të fundit janë “të dhëna që lidhen me thirrjen” apo call associated data”.
4, pika 1	Institucioni i autorizuar për administrim në qendrën monitoruese ka autoritetin, që përmes urdhërit të lëshuar nga institucionet e autorizuar në pajtim me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, të kërkojë nga Operatorët e Rrjetit apo nga Ofruesit e Shërbimeve t'i mundësohet qasja në të gjitha komunikimet elektronike e transmetuara, apo që do të transmetohen tek dhe nga numri apo ndonjë mënyrë tjetër e identifikimit të caktuar që përdoret nga përgjimi i caktuar, duke përfshirë të gjitha të dhënat që lidhen me thirrjen e që gjenerohen për të procesuar thirrjen.	Projektligji duhet të saktësojë pozicionin e gjykatave në mes të institucionit të autorizuar dhe operatorit të rrjetit. Institucioni i autorizuar kërkon autorizimin për përgjim në gjykatë, e cila kërkesë, nëse aprovohet, dërgohet në operator të rrjetit, dhe përgjimi realizohet përmes njësisë ndërlidhëse të operatorit.	Kjo pikë bie në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale sepse institucioni i autorizuar (duke menduar Policinë e Kosovës dhe AKI-në) nuk kërkon përgjimin direkt nga operatorët e rrjetit, por Prokurori i Shtetit bën kërkesë dhe Gjyqtari i procedurës paraprake e miraton apo jo këtë kërkesë, duke pasur edhe të drejtën të bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së kërkesës (Neni 91, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale). Po ashtu ky nen nuk përfillë as procedurën që ndjek AKI në procedurën e përgjimit. Sipas ligjit për themelimin e AKI, kërkesa bëhet me shkrim dhe nën betim nga personi adekuat në AKI, duhet të aprovohet nga Drejtori i AKI-së apo zëvendësdrejtori i AKI-së, e cila pastaj merr autorizimin/aprovimin vetëm pas miratimit të saj nga gjyqtari i Gjykatës Supreme të Kosovës (neni 28).
4, pika 6	Për qëllime të inteligjencës, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë do të ketë një Njësi ndërlidhëse të vendosur brenda AKI-së. Procesi i përgjimit për strukturat e inteligjencës është e rregulluar me ligjin për AKI-së dhe aktet e tjera nënligjore të nxjerrë nga Qeveria e Kosovës.	AKI duhet të ketë vetëm qendrën monitoruese, ku transmetohet përgjimi. Njësitë ndërlidhëse janë pjesë e operatorëve të rrjetit.	Siç është cekur edhe më lartë, AKI nuk mund të ketë njësi ndërlidhëse brenda vetes si institucion i autorizuar, por këto njësi janë pjesë e operatorëve të rrjetit. AKI dhe Policia e Kosovës kanë qendra monitoruese, si pika të destinacionit të telekomunikimit të përgjuar.



An EU funded project managed by the European Union Office in Kosovo

Implemented by:



9, pika 1	Bazuar në një hetim të ligjshëm, Institucioni i Autorizuar mund të parashtojë një kërkesë të shkruar tek Operatori i Rrjetit apo tek Ofruesi i Shërbimeve për t'i siguruar Institucionit të Autorizuar	Projektligji duhet të saktësojë që kërkesa e institucionit të autorizuar dërgohet në gjykatën përkatëse, pastaj nëse miratohet, në operator të rrjetit.	Kjo pikë bie në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale, nenin 84 dhe 88, të cilët përcaktojnë se vetëm në rast të një dyshimi të bazuar, Prokurori i Shtetit mund të kërkojë vënien në zbatim të masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit (neni 84), dhe që këto masa mund të vihen në zbatim vetëm nëse janë plotësuar dy kushte: 1) ekziston dyshimi i bazuar se vendi është përdorur apo personi i tillë ka kryer veprë penale, dhe 2) informacioni që merret me anë të masave të fshehta do të ndihmojë në hetimin e veprës penale, dhe se një informacion i tillë nuk ka mundur të merret me anë të mjeteve tjera.
12	Kategoritë e të dhënave që duhet ruajtur – shih këtë nen në projektligj.	Ky nen duhet të hiqet tërësisht nga projektligji ngase bazohet në Direktivën 2006/24 të BE-së e cila është shpallur jo valide më 8 prill 2014 nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë.	Ky nen është përkthyer nga Direktiva e BE-së 2006/24/EC, Neni 5, e cila është shpallë jo valide nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë me datë 8 Prill 2014. Prandaj, ky nen duhet të fshihet nga projektligji në fjalë.

Vlerësimi final:

Projektligji duhet të pësojë ndryshime përmes aktiviteteve si më poshtë:

A: A është projektligji në përputhje me legjislacionin e BE-së (*acquis communautaire*) ?

JO

Komente: Në nivel të BE-së, përgjimi i telekomunikimeve është i adresuar në Rezolutën e datës 17 Janar 1995 mbi Përgjimin Ligjor të Telekomunikimeve, e cila prezanton një listë kërkesash për institucionet e autorizuara për përgjim (law enforcement agencies) në lidhje me përgjimin ligjor të telekomunikimeve. Kjo Rezolutë vendos në një mënyrë praktikave Evropiane për përgjim, në përputhje me të cilat duhet të jetë Projektligji në fjalë. Në raportin analitik të vitit 2012 të



An EU funded project managed by the European Union Office in Kosovo

Implemented by:



Komisionit Evropian për Kosovën adresohet nevoja që Kosova të ketë një kornizë ligjore ku do të bëhej dallimi në mes të përgjimit gjyqësor dhe përgjimit për nevoja të inteligjencës, në përputhje apo në vijë me praktikat më të mira Evropiane.

B: A ka nevojë për një ri-lexim të projektligjit në mënyrë që të korrigjohet dhe të bëhet më i lexueshëm dhe lehtë i interpretueshëm:

PO

Komente: *Projektligji duhet të ri-lexohet dhe të korrigjohet ndërtimi i fjalive.*

C: A ka nevojë që projektligjit t'i bëhen disa ndryshime në mënyrë që të ketë një strukturë më të organizuar që e bëjnë atë pastaj më të lehtë në interpretim:

PO

Komente: *Projektligji duhet të ndryshohet sipas komenteve dhe arsytimit të dhëna në këtë formë, dhe sipas neneve të propozuara më poshtë.*

D: A ka nevojë projektligji për më shumë dispozita në mënyrë që të jetë më i plotë dhe të përmbledhë më mirë fushën të cilën e rregullon:

PO

Propozoni nenet/dispozitat që duhet t'i shtohen projektligjit:

- 1. Nen të veçantë mbi parimet e përgjimit si respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, p.sh. e drejta e privatësisë.*



An EU funded project managed by the
European Union Office in Kosovo

Implemented by:



2. *Nen të veçantë mbi atë se përgjimi i telekomunikimeve kryhet vetëm mbi atë për çfarë është marrë autorizimi për përgjim sipas kërkesës për përgjim, dhe nuk duhet të përfshijë përgjim jashtë specifikave të kërkesës për përgjim.*
3. *Nen të veçantë mbi kohën e aktivizimeve të përgjimeve në situata emergjente.*
4. *Nen të veçantë mbi kërkesën për përgjim dhe institucionin ku duhet të dorëzohet kërkesa për përgjim. Këtu duhet të specifikohet forma e kërkesës se çka duhet të përmbajë ajo.*
5. *Nen të veçantë mbi dhënien e pëlqimit apo lejes për përgjim, institucionin kush e jep lejen, formën e vendimit për leje dhe kohën për sa vlen vendimi (p.sh. 3 muaj). Këtu duhet të specifikohet edhe për sa kohë mund të vazhdohet vendimi për përgjim.*
6. *Nen të veçantë mbi anulimin e vendimit për përgjim nëse institucioni që e ka lëshuar atë vlerëson se nuk ka më nevojë për përgjim.*
7. *Në përgjithësi, projektligji duhet t'i kushtojë më shumë rëndësi tërë procedurës dhe kushteve për realizimin e përgjimit. Nga forma e kërkesës, institucioni ku deponohet kërkesa, vendimi për apo kundër përgjimit, kohëzgjatja e përgjimit, etj.*

Arsyetimi:

Projektligji bën një centralizim të përgjimeve në AKI meqë ky institucion sipas projektligjit do të ketë njësinë ndërlidhëse dhe qendrën monitoruese. Projektligji nuk përmban asnjë dispozitë për respektimin e të drejtës së privatësisë garantuar me Kushtetutë, dhe nuk sqaron tërë procedurën e realizimit të përgjimit. Projektligji duhet të jetë i plotë dhe të përshkruaj në hollësi tërë procesin e realizimit të përgjimit.

E: A interferon ligji me ndonjë ligj apo akt nënligjor që aktualisht është në fuqi?

PO



An EU funded project managed by the European Union Office in Kosovo

Implemented by:



Nëse po, cilat janë ato ligje dhe akte nënligjore?

Ligji Nr.03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë ngase kjo Agjenci nuk ka njësi të ndërlidhjes siç ceket në këtë projektligj. Po ashtu, projektligji bie në kundërshtim edhe me Kodin e Procedurës Penale në rastet e përshkruara më lartë.

F: Projektligji duhet të shkojë nëpër këto procedura:

1. Projektligji duhet t'i kthehet Qeverisë për korrigjim.

2. Për korrigjimin e tij duhet të krijohen dy grupe punuese, njëri grup i përbërë nga njohës të fushës të cilët shkruajnë pjesën esenciale të projektligjit, dhe grupi i dytë i përbërë nga institucionet përkatëse i cili do të komentonte dhe shtonte pjesët tjera të projektligjit.

Forumi i OJQ-ve konsideron që adresimi i këtyre rekomandimeve është me rëndësi të lartë për projektligjin në kuptimin e:

- a) Implementimit;
- b) Standardeve të të drejtave të njeriut;
- c) Standardeve evropiane;



An EU funded project managed by the
European Union Office in Kosovo

Implemented by:

